

Vendim nr. 200 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: DJANA KASAPI

OBJEKTI: Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr. 87, datë 26.04.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja ka qenë pjesë e shërbimit civil në funksionin e përgjegjëses së sektorit të arkivit dhe protokollit në Drejtorinë Ekonomike, të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Drejtësisë. Ajo është liruar nga shërbimi civil me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie, për shkak të ristrukturimit të institucionit, vendim i cili është miratuar nga Departamenti i Administratës Publike (*DAP*) dhe kërkesja ka kaluar në listë pritjeje. Duke mos qenë dakord me aktin e lirimit nga shërbimi civil dhe kalimin në listë pritjeje, kërkesja ka ankimuar aktin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së

Drejtësisë fillimisht në Komisionin e Shërbimit Civil, dhe më pas në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë vendosur rrëzimin e saj.

2. Në lidhje me sa më lart, në datën 19.02.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për mospranimin e rekursit të saj, si dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

3. Me vendimin nr. 87, datë 26.04.2024 (*vendimi nr. 87/2024*), Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për seancë plenare, duke vlerësuar si haptazi të pabazuara ose jashtë juridiksionit gjyqësor pretendimet e ngritura nga kërkesja në ankimin kushtetues individual. Kopja e këtij vendimi i është dërguar kërkueses me shkresën nr. 1 (D) 2024 Regjistri Themeltar, datë 21.05.2024, të Gjykatës.

4. Në datën 15.07.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 87/2024 të Kolegjit të saj. Si relatore për shqyrtimin paraprak të kësaj kërkesë është caktuar fillimisht gjyqtarja Elsa Toska, për të cilën, me vendimin nr. 62, datë 23.09.2024 të Gjykatës është vendosur deklarimi i mbarimit të mandatit përpara afatit, për shkak të dorëheqjes. Në vijim, relatore e çështjes është caktuar gjyqtarja Sonila Bejtja, ndërsa përbërja e Kolegjit është caktuar me vendimin nr. 14, datë 23.09.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës.

II

Pretendimet e kërkueses

5. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

5.1. *Saktësimin e vendimit nr. 87/2024 të Kolegjit të Gjykatës*, pasi ai nuk ka paraqitur në mënyrë reale pretendimet e parashtruara prej saj në rekurs, duke i cunguar e transformuar ato dhe duke i nxjerrë jashtë kontekstit. Kështu, Kolegji i Gjykatës nuk ka pasqyruar të plotë qëndrimin e mbajtur në vendim nga gjykata e apelit, vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë të përfshirë në vendimin e prokurorisë ose konstatimet dhe rezultatet thelbësore të arritura nga ky organ. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë ajo nuk ka pretenduar kryerjen e vlerësimeve të ndryshme nga gjykatat, se gjykata e rrethit i ishte përmbajtur vetëm rasteve të pavlefshmërisë absolute ose se gjykata e apelit kishte arsyetuar se mungesa e procedurës në lidhje me krahasimin e punës nuk përbënte shkelje flagrante të ligjit. Po kështu, në rekurs ajo nuk ka pretenduar se arsyetimi i

gjykatës në lidhje me pasojën për pagimin e pagës ishte i pabazuar, pasi ligji nuk parashikonte periudhën e pagesës, por ruajtjen e nivelit të pagës për 1 vit e, më pas, mundësinë e ofrimit të një vendi pune të një niveli më të ulët. Kolegji i Gjykatës ka marrë të mirëqena vetëm përshkrimet e bëra në vendim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që nuk u është referuar pretendimeve të ngritura prej saj në rekurs.

- 5.2. *Plotësimin* e vendimit nr. 87/2024 të Kolegjit të Gjykatës, pasi vlerësimet e bëra në pikat 26, 29 dhe 30 të tij nuk i përgjigjen realitetit. Arbitrariteti i zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit ishte i dukshëm, ndaj si Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ashtu edhe Kolegji i Gjykatës duhej të mbanin qëndrim. Qëllimi i Kolegjit të Gjykatës në pasqyrimin e qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë nuk arrihet të kuptohet.
- 5.3. Vendimi nr. 87/2024 i Kolegjit të Gjykatës i ka cenuar garancinë e qëndrimit në detyrë, trajtimit ligjor dhe zhdëmtimit në përputhje me ligjin. Vendimit i mungojnë argumentet për pabazueshmërinë haptazi të kërkesës dhe për mosshterimin e mjeteve juridike përpara se kërkesja t'i drejtohet Gjykatës. Gjykata duhej të ndërhynte, pasi zbatimi i ligjit në rastin e saj kishte qenë arbitrar, në kundërshtim të hapur me konceptin e gjykimit të drejtë.
- 5.4. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë, i cili i ka konsideruar, *a priori*, të pabazuara shkaqet e ngritura në rekurs, duke radhitur shkaqet ligjore për rekurs, kufizon aksesin dhe cenon thelbin e së drejtës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 6 të KEDNJ-së. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmban asnjë arsyetim për mospranimin e vendimeve të Kolegjeve Administrative dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të cilat ajo ka pretenduar se binin ndesh me vendimin e gjykatës së apelit. Vendimi i saj nuk ka garantuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkeses

6. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se çdo individ, përfshi personin juridik, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës,

mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e aktit të kundërshtuar (*shih vendimet nr. 18, datë 31.03.2014; nr. 60, datë 28.12.2012; nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesa ka në objektin e saj saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 87/2024 të dhënë nga Kolegji i Gjykatës, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak të saj. Me anë të këtij vendimi është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se: (i) në lidhje me pretendimin për largimin nga puna për arsye politike, kërkesja nuk kishte shteruar mjetet juridike në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës dhe nenit 31/a, pika 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577/2000; (ii) pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e ulëta në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe mospëmbledhjen nga kjo e fundit të njësimin ose zhvillimit të praktikës gjyqësore, nuk përfshiheshin në juridiksionin kushtetues; (iii) pretendimet e tjera, të cilat kishin të bënin në thelb me të drejtën e aksesit në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, ishin haptazi të pabazuara. Në datën 15.07.2024 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës, duke kërkuar saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 87/2024 të Kolegjit të saj.

8. Kushtetuta në nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, shprehet qartësisht në lidhje me forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, ligji nr. 8577/2000 parashikon se vendimet e Gjykatës janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim (*shih nenet 72/7 dhe 76/1 të tij*). Neni 80, pika 1, përcakton të drejtën e Gjykatës për të saktësimin dhe plotësimin e vendimeve të saj. Në këto kushte Gjykata ka të drejtë, nëpërmjet kërkesës, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.

9. Gjithashtu, referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit 8577/2000, nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës për rihapje të procesit gjyqësor.

10. Në vështrim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të mësipërme, si dhe rrethanave faktike, Kolegji evidenton se vendimi i kundërshtuar nr. 87/2024 i është dërguar kërkueses në datën 22.05.2024, ndërsa kërkesa konkrete drejtuar Gjykatës është depozituar në shërbimin postar në datën 15.07.2024, pra brenda afatit 2-mujor që parashikon nenin 80, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000. Po kështu, në përmbajtje të kërkesës, kërkuësja ka kërkuar saktësimin e vendimit nr. 87/2024 të Kolegjit të Gjykatës, për shkak se, sipas saj, në të nuk janë pasqyruar saktë pretendimet e parashtruara prej saj në rekurs. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji konstaton se, në thelb, ai ka të bëjë me mënyrën e pasqyrimin të pretendimeve të rekursit të kërkueses në vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues individual të parë. Këto pretendime, të cilat ngrihen, në thelb, në drejtim të cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë, si rrjedhojë e vendimit të saj nr. 00-2023-4701, datë 16.11.2023, nuk janë parashtruar nga kërkuësja në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës të datës 19.02.2024, por ngrihen për herë të parë në ankimin kushtetues individual konkret. Në kushtet kur vendimi i Gjykatës së Lartë është i datës 16.11.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual konkret është paraqitur në datën 15.07.2024, Kolegji vlerëson se kërkuësja nuk legjitimohet *ratione temporis* në lidhje me këto pretendime.

11. Për sa i përket kërkesës për plotësimin e vendimit nr. 87/2024 të Kolegjit të Gjykatës, kërkuësja ka pretenduar se qëndrimi i mbajtur në të nuk i përgjigjet realitetit, nuk kuptohet qëllimi i pasqyrimin të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, vendimit i mungojnë argumentet për pabazueshmërinë haptazi të kërkesës dhe për mosshkrimin e mjeteve juridike.

12. Për sa u përket pretendimeve për mosarsytimin në vendimin nr. 87/2024 në lidhje me mosshkrimin nga kërkuësja të mjeteve juridike në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës, Kolegji vëren se një vlerësim i tillë është bërë në lidhje me pretendimet e saj për largimin nga puna për arsye politike, ndërkohë që në kërkesën konkrete në shqyrtim, vetë kërkuësja e ka pranuar si të drejtë këtë qasje të vendimmarrjes nr. 87/2024 të Kolegjit të Gjykatës (*shih faqen 7, paragrafi 3, të kërkesës*).

13. Po kështu, sa u përket pretendimeve se vendimi nr. 87/2024 nuk i përgjigjet realitetit dhe se ai nuk përmban argumentet për pabazueshmërinë haptazi të kërkesës, në analizë të këtij vendimi Kolegji konstaton se në të janë pasqyruar pretendimet e kërkueses, të cilat kishin të bënin me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së aksesit, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe interpretimin e zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat, si dhe të garancisë së qëndrimit në detyrë e trajtimit ligjor të nëpunësve publikë e së

drejtës për t'u rehabilituar në përputhje me ligjin. Në vendimin nr. 87/2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur të mos e legjitimojë kërkuesen në lidhje me pretendimin për largimin për arsye politike nga detyra, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike efektive, ndërsa pretendimet e tjera ka çmuar t'i trajtojë në kuadër të së drejtës së aksesit në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të kërkesës, Kolegji ka vlerësuar se gjykatat kishin mbajtur qëndrim të arsytuar në lidhje me pretendimet e ngritura nga kërkuesja gjatë gjykimit dhe se mospasqyrimi i saktë i faktit të paraqitjes nga kërkuesja të rekursit nuk e bënte procesin të parregullt në këndvështrimin kushtetues.

14. Kolegji vëren, gjithashtu, se në ankimin kushtetues individual konkret kërkuesja ka ngritur pretendime edhe për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit, si rrjedhojë e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, si dhe për cenimin e garancisë së qëndrimit në detyrë, trajtimit ligjor dhe zhdëmtimit në përputhje me ligjin, pretendime të cilat, në thelb, janë të njëjta me ato për të cilat ajo ka marrë përgjigje në vendimin nr. 87/2024 të Kolegjit të Gjykatës.

15. Në këndvështrim të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim nga sa pretendohet nga kërkuesja, në vendimin nr. 87/2024 Kolegji i Gjykatës ka vepruar në përputhje me standardet e gjykimit kushtetues dhe se në rastin konkret kërkuesja nuk gjendet në asnjë nga situatat e parashikuara nga nenet 71/c, pikat 3 e 4 dhe 80, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesa e saj drejtuar Gjykatës për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 87/2024 të Kolegjit të Gjykatës nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.